VENDIM
Nr. 455, datë 27.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 79, DATË 28.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I AMFITEATRIT TË DURRËSIT""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 4 e vendimit nr. 79, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 21 660 027 (njëzet e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëzet e shtatë) lekësh, të përballohet përkatësisht:

- 18 179 227 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzet e shtatë) lekë nga llogaria e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë, "Fondi i shpronësimeve";
- 3 510 800 (tre milionë e pesëqind e dhjetë mijë e tetëqind) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama